



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

## PROCESVERBAL

### Nga mbledhja e XII-të (XI-të për v. 2010) e Kuvendit Komunal në Vushtrri, mbajtur më 30.12. 2010

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri, përveç Xhemajl Pllanës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO (Zyra Civile Ndërkombëtare), përfaqësuesi i ICITAP-it dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë.

**Ferit Idrizi**- propozoi dy ndryshime në rendin e ditës: propozoi që të hiqet pika nr. 5 nga rendi i ditës, pasi që nuk i posedon dispozitat përfundimtare dhe ka nevojë që të jepen edhe sugjerime tjera nga përfaqësuesit e shkollave të mesme. Gjithashtu tha se është edhe një kërkesë të nënshkruar nga 53 banorë të fshatit Druar, pasi që Agjencioni Kosovar i Privatizimit ka tenderuar dhe privatizuar pronat të cilat me dekada janë duke i punuar banorët e fshatit në fjalë, prandaj edhe pse nuk është në kompetencën e Kuvendit Komunal të merr vendim lidhur me çështjen në fjalë, mirëpo është në kompetencën e Kuvendit Komunal që t'i rekomandon AKP-së që ta rishqyrton lëndën dhe Qeverisë, që të jenë të kujdesshme. Në fund propozoi që çështja në fjalë të futet në "të ndryshme".

**Besim Jashari**- paraqiti vërejtje për propozimin që u bë për heqjen e pikës 5 të rendit të ditës, duke shtuar se nuk është hera e parë që po ndodh me heqjen e pikave nga rendi i ditës, kurse vënies së pikave të rendit të ditës i prinë dhe do të duhej t'i prinë një procedurë, dhe nëse ky rend dite ka kaluar nëpër KPF, dhe pika nr 5 ka ardhur për shqyrtim të dytë në Kuvend, dhe nuk është mirë për Kuvendin që përsëri kërkohet të hiqet nga rendi i ditës pika e rendit të ditës në fjalë, pasi që në këtë mënyrë po zbehet qasja serioze e anëtarëve të Kuvendit. Në fund duke bërë vërejtje, tha se pikat që vijnë në rend dite, duhet të ketë një arsye shumë të madhe, një ndikim të jashtëzakonshëm që të kërkohet heqja e ndonjë pike të rendit të ditës.

**Qazim Azemi-** në emër të grupit asamblistë të AAK-së, lidhur me rendin e ditës, tha se zakonisht po shkelet neni 15, pasi që nuk është transparent rendi i ditës, nuk po vendoset në tabelën e shpalljeve, dhe nganjëherë po vjen me vonesë materiali i seancave të Kuvendit. Gjithashtu paraqiti vërejtje që ka raste për pika të caktuara të rëndësishme të rendit të ditës, delegatët e marrin materialin në ditën e seancës. Pastaj tha se nëse shikohet plani vjetor i punës, për muajin 12, në rend dite mungon pika kryesore që do të ishte raporti për situatën ekonomike- financiare dhe për zbatimin e planeve investuese në 6-mujorin e dytë të vitit 2010, duke kërkuar nga Kryesuesi i Kuvendit arsyen pse nuk është kjo pikë e rendit të ditës. Poashtu edhe neni 19 po shkelet, kurse sa i përket pikës nr 5, pajtohet që të hiqet nga rendi i ditës, dhe tha se duhet të përpilohet një rregullore më e përpunuar, duke e sugjeruar drjetorin e arsimit që të konsultohet edhe me Komitetin Konsultativ për Arsim, dhe në këtë mënyrë të del një rregullore më e plotë.

**Ferit Idrizi-** sqaroi se është raporti i punës i Kryetarit për 6-mujorin e dytë, por tha se do të insiston që me planifikimin e punës së Kuvendit për vitin 2011, raporti i punës së Kryetarit të paraqitet në seancën e janarit të vitit pasues, duke shtuar se nëse keni vërejtje (pasi që vonë iu ka ardhur materiali) mund ta shtyjme edhe raportin e punës së Kuvendit për janarin e vitit 2011, pasi që për seancën e janarit janë të kompletuara të gjitha të dhënat për të dy raportet.

**Sabit Kadriu-** tha se sot është dashtë jetë një raport, të bëhet një rekapitullim i tërë punës që është bërë në vitin 2010, kurse plani i punës së Kryetarit do të kishte kohë që të shqyrtohej menjëherë në fillim të vitit të ri.

**Bajram Mulaku-** tha se pajtohet që materiali për seanca të Kuvendit po iu shkon me vonesë anëtarëve të Kuvendit, duke shtuar se është mirë edhe në Ligjin për Pushtetin Lokal duhet me i bërë disa ndërrime, pasi që më tepër se gjysma e muajit duhet llogaritur hapësirë kohore për përgatitjen e materialit për anëtarët e Kuvendit për seancat e Kuvendit (duke përfshirë këtu edhe përgatitjet për mbledhjet e KPF-së), dhe shtoi se vonesa e dërgimit të materialit për seanca është një praktikë që po vazhdon të përsëritet qysh nga mandatet e kaluara. Sa i përket raportit të punës dhe planit të punës, tha se plani i punës gjithmonë bëhet para se të fillon viti fiskal, ndërsa raporti i punës nuk mund të përgatitet, pa përfunduar viti në tërësi, prandaj ky vit akoma nuk ka përfunduar, dhe shtoi se asnjëherë nuk është bërë raporti i punës, akoma pa përfunduar viti. Në vazhdim lidhur me vërejtjen e paraqitur nga B.Jashari, tha se gati çdo seancë ka ndodhur, pasi që edhe vet opozita ka kërkuar në raste të ndryshme që të hiqen pika të ndryshme nga rendi i ditës, kurse sot Kryesuesi e propozoi që të hiqet pika nr 5 e rendit të ditës, dhe nuk ka asgjë të keqe nëse hiqet.

**Ferit Idrizi-** duke e përkrahur edhe propozimin e Q.Azemit, kërkoi që edhe pika nr 3 të hiqet nga rendi i ditës.

**Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi në mënyrë unanime aprovoi këtë:**

***Hiqen pikat 3 dhe 5 të rendit të ditës, kurse shtohet në “të ndryshme” Kërkesa e qytetarëve të fshatit Druar.***

## **REND DITE**

### **1. Eventuale:**

**Shqyrtimi i kërkesës së qytetarëve nga fshati Druar, lidhur me privatizimin e disa parcelave në këtë fshat.**

**2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e KK-së.**

**3. Shqyrtimi i Planit të punës të Kryetarit të Komunës për v. 2011.**

4. Shqyrtimi i informatës lidhur me realizimin e të hyrave vetanake buxhetore për muajin nëntor 2010.
5. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për dhënien e lejes së punës të bizneseve në territorin e Komunës së Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).
6. Shqyrtimi i sërishëm i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të tokës në pronësi të Komunës sipas kërkesës së MPB të Republikës së Kosovës.
7. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për fillimin dhe mbarimit të orarit të punës të bizneseve në lëmin e tregtisë, hotelerisë, zejtarisë dhe shërbimeve tjera në territorin e Komunës së Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).
8. Shqyrtimi propozim-vendimit për dhënien me qira të lokalit pronë e komunës, (lokali para objektit për banim social – lokacioni ish Vushteksi).

#### 1. Eventuale:

**Shqyrtimi i kërkesës së qytetarëve nga fshati Druar, lidhur me privatizimin e disa parcelave në këtë fshat.**

**Salih Salihu-** paraqiti sqarimet hyrëse.

**Ferit Idrizi-** tha se për çështjen në fjalë nuk është kompetent Kuvendi i Komunës që të nxjerr vendim, por është në nderin e Kuvendit që për çështjet që paraqiten, kërkesat e qytetarëve, peticionet e ndryshme t'i shqyrton dhe të nxjerr rekomandime të ndryshme.

**Sabit Kadriu-** tha se AKP-ja është konsideruar pronar i të gjitha pronave, pa marrë parasysh historinë e pronave. Pastaj tha se në vitet 1918 dhe 1922 është bërë një kolonizim i tokave shqiptare nga serbët e ardhur nga Lika, dhe kjo që i ka ndodhur fshatit Druar, i ka ndodhur të gjitha fshatrave të Artakollit, por edhe në pjesët tjera të territorit të komunës sonë. Mandej tha se duhet t'ia bëjmë me dije AKP-së se privatizimi i tokave duhet bërë duke shikuar historikun e pronave. Në vazhdim tha se përfaqësuesit e fshatit Druar paskan informata se ku janë tjetërsuar tokat e tyre, prandaj për të mos lejuar konfliktin, neve na bjen një përgjegjësi e madhe që t'i thërrasim njerëzit kompetent që merren me problemet pronësore-juridike dhe të bëhen sqarimet e nevojshme që të mos ngatërrohen në pronat që kanë qenë të dikujt tjetër, kurse sot dikush dëshiron t'i shfrytëzon si të gatshme, pa e ditur historikun e tyre, duke shtuar se në bazë të ligjeve ndërkombëtare prona është e shenjtë.

**Sami Istrefi-** propozoi që ky Kuvend të formon një komision, dhe komisioni të merret me urgjencë duke kontaktuar me Kuvendin e Kosovës, duke bashkërenduar reagimet ligjore me faktet e prezantuara nga fshatarët, pasi që AKP-ja është trupë e Kuvendit të Kosovës dhe i jep llogari institucionit më të lartë të shtetit, pra Kuvendit të Kosovës. Në fund tha se bazuar në informatat që ka, AKP-ja asnjëherë nuk e ka komunikuar Komunën e Vushtrrisë, por as komunat tjera për privatizimin e ndonjë prone të caktuar, dhe njëjtë është vepruar edhe me privatizimin e pronave në fshatin Druar.

**Besim Jashari-** tha se çështja në fjalë është shumë e ndijshme, dhe dihet që për prona kanë ndodh probleme edhe në të kaluarën, dhe nuk është për t'u habitur që mund të ndodhin edhe tash, prandaj autoritetet komunale, duke përfshirë edhe Kuvendin, e kanë përgjegjësinë më të lartë që të mbrojnë interesin e qytetarëve të vet, t'i mbrojnë ata edhe nga konfliktet eventuale që

mund të vijnë pa dëshirën e tyre. Në vazhdim tha është mirë që Kryetari i Komunës me autoritet tjera të dalin në vendin e ngjarjes, është edhe Këshilli i fshatit, pra të hyjnë në funksion të gjithë mekanizmat relevantë dhe të shikohet se çka mund të ndërmerret në mënyrë që të parandalohet ajo që nuk e dëshiron askush, dhe shtoi se ka raste kur në mungesë të fakteve, merret ndonjë vendim, prandaj duhet të prezantohen faktet në mënyrë që të merret vendimi më i mirë i mundshëm. Në fund kërkoi që çështja në fjalë të trajtohet shumë seriozisht nga Kuvendi i Komunës, dhe të shikohet që mbi bazën e fakteve të gjendet zgjidhja më e mirë e mundshme ligjore.

**Muharrem Shabani-** tha se çështja në fjalë nuk është vetëm karakteristikë e fshatit Druar, por është karakteristikë e komunës dhe e Kosovës. Pastaj shtoi se në të gjitha vendet e tranzicionit janë nxjerr ligje me kohë të caktuar për çështjen e denacionalizimit, dekolonizimit dhe dekonfiskimit të pronave që kanë ndodh gjatë fazave të ndryshme të historisë, kurse në vendin tonë ende këto ligje nuk janë nxjerr, prandaj është kërkesë imanente që organet e Kosovës, duke filluar nga Kuvendi, si organi më i lartë, këtë çështje ta shqyrtojnë në mënyrën serioze. Poashtu kërkoi që Kuvendi të merr një qëndrim, përmes të cilit Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit me përfaqësues tjerë, në bazë të kërkesave të përgjithshme, këtë çështje ta inicojnë, dhe shtoi se për këtë çështje jemi të pafuqishëm në suaza të kompetencës me ndërmarr diçka të veçantë, por dihet që toka nuk mund të bartet prej aty ku është, por mbetet aty, prandaj është mirë që të informohen me shkrim me qëndrimet e Kuvendit edhe organet më të larta, dhe të merren masat adekuate.

**Bajram Mulaku-** tha se çështjet e pronësisë gjithmonë janë delikate. Pastaj tha para tri vitesh janë marrë disa vendime për shpalljen e disa tokave me interes të përgjithshëm, toka të cilat AKP-ja i ka marrë tani në pronësi për t'i privatizuar, prandaj edhe Komuna ka probleme me AKP-në. Mandej njoftoi se toka te "Vush-tex"-i është pronë komunale, prandaj ka marrë vendim që të lejohet ndërtimi i shkollës së mesme të gjimnazit në atë hapësirë, kurse AKP-ja e ka padit institucionin komunal dhe Kryetarin e Komunës, pra jemi në kontest me AKP-në për këtë çështje. Në vazhdim tha se jo vetëm interesi i pronarëve privat, por edhe interesi i komunës si institucion është cenuar në shumë raste. Pastaj tha se kanë bërë kërkesë te AKP-ja për të bërë ndërrim të pronave, por as për këtë nuk ka pasë gatishmëri nga AKP-ja. Mandej tha se është aprovuar ligji që e rregullon çështjen e privatizimit, prandaj duhet me kërkuar forma që në kuadër të ligjit në fjalë për realizmin e interesave edhe të komunës, por edhe të qytetarëve. Në fund propozoi që të shkruhet një shkresë për AKP-në, me këtë përmbajtje: Kuvendi Komunal i Vushtrisë me datën 30.12.2010, e ka shqyrtuar kërkesën e banorëve të fshatit Druar lidhur me të drejtën e pronësisë së tokës në këtë fshat, pra bëhet fjalë për 53 prona, për të cilat AKP-ja ka shpallë tender për shitje dhe të njëjtat i ka shitur. Kuvendi Komunal i rekomandon AKP-së që ta rishqyrton vendimin e vet për shitjen e pronave në fjalë dhe të merr parasysht argumentet e qytetarëve të fshatit Druar. Lidhur me kërkesën në fjalë të njoftohet Ministria e Pushtetit Lokal, dhe nga e njëjta kërkohet që të ipet një sqarim ligjor lidhur me kërkesën në fjalë për qytetarët e fshatit dhe të drejtat e tyre. Pasi që nuk është në kompetencë të Kuvendit Komunal që të marrë vendime lidhur me kontestin në fjalë, ju sugjerojmë qytetarëve të fshatit Druar që të përdorin të gjitha format ligjore për mbrojtjen e interesave të tyre.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

**Kuvendi i Komunës aprovoi këtë:**

#### *REKOMANDIM*

- a. *Kuvendi i Komunës i rekomandon Agjensionit Kosovar të Privatizimit që ta shqyrtoj kërkesën e banorëve të fsh. Druar dt. 29.12.2010 dhe argumentet e paraqitura në atë kërkesë.*
- b. *Meqenëse Kuvendi i Komunës në Vushtrri nuk është kompetent për marrje të çfarëdo vendimi lidhur me pronat në fjalë, iu sugjerohet parashtruesve të kërkesës që të shfrytëzojnë të gjitha mjetet ligjore të mundshme pran organeve kompetente në bazë të ligjit në Republikën e Kosovës, për mbrojtje të interesave të tyre lidhur me këtë çështje.*
- c. *Me këtë rekomandim njoftohen: AKP dhe përfaqësuesi i grupit të banorëve të fsh. Druar, parashtrues të kësaj kërkesë, dhe Qeverinë e Kosovës, gjegjësisht ministrinë përkatëse.*

## **2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e KK-së.**

**Besim Jashari-** lidhur me diskutimin e tij, në faqen e parë, tha se ka qenë çështja e propozuar nga ana e Kryesuesit të Kuvendit që të hiqen dy pika nga rendi i ditës, dhe intervenimi i tij ka qenë që kur të propozohet heqja e një pike të rendit të ditës, të ipet një arsytim i qëndrueshëm pse po kërkohet heqja e pikës së caktuar nga rendi i ditës, kurse përpiluesi i procesverbalit në fjalë iu ka shmangur asaj që e kam thënë. Kurse në faqe 3, tha se e ka cituar Kryetarin e Komunës, i cili ka thënë: “nuk jam aspak i kënaqur me realizimin e të hyrave vetanake” dhe poashtu kam thënë se nëse Kryetari i Komunës pohon para Kuvendit se nuk është aspak i kënaqur me inkasimin e të hyrave, pse nuk ka llogaridhënie dhe përgjegjësi.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

***Aprovohet procesverbali i mbledhjes së fundit të Kuvendit të Komunës, me vërejtjen e paraqitur nga: B.Jashari.***

## **3. Shqyrtimi i Planit të punës të Kryetarit të Komunës për v. 2011.**

**Bajram Mulaku-** tha se një prej qëllimeve të tij është realizimi i projekteve kapitale të planifikuara për vitin 2011 nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, e të cilat kanë të bëjnë në mënyrë të veçantë me infrastrukturë rrugore, të ujërave fekale, të rrjetit të ujësjellësit, për ujë të pijshëm dhe për ujë të ujitjes. Pastaj hartimin e projekteve kapitale, për mbikëqyrjen e projekteve, për pranim teknik të projekteve, për hartimin e planeve rregulluese. Gjithashtu planifikimet që kanë të bëjnë me kadastër dhe gjeodezi, shëndetësi, mirëqenie sociale, kulturë, rini, sport, arsim dhe të gjitha niveleve, duke përfshirë edhe administratën komunale. Mandej tha se një ndër qëllimet e tij është edhe realizimi, gjegjësisht tejkalimi i të hyrave të brendshme të planifikuara për vitin e ardhshëm. Poashtu synon që të krijon kushte për punësim të rinjve, në veçanti në ndërmarrje prodhuese të vogla, ose të mesme dhe në bujqësi. Në vazhdim njoftoi se do të vazhdon ndërtimi i rrugës dhe bulevardit “Dëshmorët e Kombit” dhe “Skënderbeu”, pastaj do të punohet në mirëmbajtjen e higjienës nëpër rrugët e qytetit, shtratit të lumit, dhe të gjelbërimeve ekzistuese të

qytetit. Pastaj tha se do të vazhdohet me bashkëpunim të ngushtë me shoqatat e dala nga lufta për përkujdesjen e familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës, duke shtuar se do të bëjmë përpjekje që të ndërtohen objekte banimi për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe familjeve me gjendje të rëndë sociale, mandej do të vazhdohet me përkujdesjen ndaj mirëqenies shëndetësore ndaj të gjithë qytetarëve të komunës. Gjithashtu, njoftoi se në vitin e ardhshëm pritet të filloi nga puna objekti i qendrës kryesore të mjekësisë familjare në Vushtrri dhe të disa ambulanteve nëpër disa fshatra, dhe do të vazhdojmë që të përkujdesemi për ngritjen e cilësisë mësimore, duke shtuar se një përkujdesje e veçantë duhet t'iu kushtohet fëmijëve parashkollor, dhe gjithashtu të vazhdohet të punohet në funksionalizimin e shkollës së muzikës në qytet. Mandej tha se pritet që vitin e ardhshëm të përfundojnë punimet në ndërtimin e gjimnazit, dhe me këtë rast do të krijohen kushte elementare për punë më të mirë edhe në të dy shkollat tjera teknike. Një përkushtim të veçantë do ta ketë në përfundimin e të gjitha projekteve kapitale, që në këtë vit kanë filluar, por që nuk janë përfunduar për shkaqe të ndryshme, duke përmendur në mënyrë konkrete disa nga projektet në fjalë.

**Veli Karaça-** tha se ky plan i punës është më i rëndësishmi që ne e diskutojmë dhe e aprovojmë, dhe është hap fillestar për punën që na pret në vitin 2011. Pastaj tha se plani në fjalë është shumë i përgjithësuar, dhe më tepër i përngjan një strategjie për të cilën përsëri do të duhej të përpilohej një plan i zbatimit, pasi që këtij plani i mungojnë komponentet kryesore, e që janë: qëllimi, objektivat konkrete ose deklaratimet për rezultatet specifike (të cilat do të duhej të jenë të matshme, të arritshme, motivuese dhe të përshtatshme), kurse pas tyre vjen planifikimi i aktiviteteve apo gjërat që do t'i ndërmarrim për t'i përmbushur objektivat, dhe këto aktivitete pastaj radhiten sipas prioritetit, mirëpo të gjitha këto aktivitete duhet ta kenë: arsyen, kohën, koston, mënyrën se si do të zhvillohen, dhe një plan i tillë do t'i shërbente për punë Kryetarit dhe administratës komunale, pasi që t'i drejtonte të gjitha aktivitetet e administratës komunale. Në vazhdim ai tha se nuk i ka ardhur në email materiali që ka të bëjë me planin e punës, kurse lidhur me prioritetet e parapara të drejtorive komunale, tha se janë të përgjithshme, duke shtuar se vetëm Drejtoria për Ekonomi i ka dy aktivitete konkrete: hapjen e qendrës së bizneseve komunale dhe dhënien e tregut në shfrytëzim privat, kurse për të gjitha aktivitetet tjera nuk dihet as kur fillojnë, as kur mbarojnë, as nuk e kanë koston e vet, prandaj dhe nuk mund të monitorohen dhe të vlerësohen në fund. Mandej tha se nëse një plan është në detaje i konkretizuar, do të shërbente si komunikim në mes të organeve komunale edhe për koordinimin e punëve. Në fund tha se ky plan më tepër është një përpjekje për të identifikuar disa prioritete vjetore, për të cilat nëse realizohen duhet të ekziston edhe për këtë plan, një plan tjetër më i detajizuar, pasi që ky plan në këtë formë nuk garanton që mund të monitorohet.

**Bajram Mulaku-** tha se plani në fjalë përmban vetëm prioritetet themelore të secilës drejtori, kurse në email iu është dërguar anëtarëve të kuvendit secili projekt i të gjitha drejtorive në mënyrë të detajuar.

**Qazim Azemi-** tha se plani në fjalë është më tepër një draft, dhe ka vend për kritika, vërejtje, duke shtuar se plani në fjalë duhet të jetë më i shkoqitur, më i qartë. Pastaj lidhur me tebalën e buxhetit (në faqe nr.3), te rubrika "Të hyrat vetanake" nuk përputhet me tabelën 4.2, prandaj pyeti pse ky ndryshim? Poashtu kërkoi që tabela e buxhetit të jetë më e qartë, pasi që është e përgjithësuar. Mandej te prokurimi (në faqe nr. 4), lidhur me prioritetet, kërkoi të paraqiten më konkretisht, më hapur, pra të parashihen disa gjëra që janë më transparente. Kurse tek shërbimet publike, tha se nëse shikohet plani i vitit të kaluar, e kemi pasë prioritet rrugën kryesore, hyrje-daljet të Vushtrrisë, rrugën "Dëshmorët e Kombit" dhe rrugën "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu", ndërsa në këtë plan të punës është vetëm rruga "Dëshmorët e Kombit", dhe kërkoi që të mos hiqet, por është mirë që të futet edhe rruga "Gjergj Kastrioti- Skënderbeu", poashtu janë edhe dy hyrje-daljet në Mitrovicë. Prandaj këto

dy rrugë që janë më të gravituarat, më të rëndësishmet, bile të meremetohen. Në vazhdim lidhur me arsimin, tha se vitin që shkoi ka pasë shumë prioritete, por sivjet janë shkurtuar prioritetet. Dhe kërkoi që çështja e fëmijëve me të meta (të retarduar) të rregullohet, dhe të mos mbesin në baraka ato dy klasa. Mandej tha se janë hequr krejt shkollat, por nëse krahasohet ky plan me planin e vitit të kaluar, atje kanë qenë si prioritete disa lokalitete që janë të largëta, që janë: Zhilivoda, Karaça, që mjerisht akoma është shkollë barakë, e këtu nuk figuron fare. Gjithashtu në këtë plan duhet të futen në prioritet edhe meremetimet për shkollat “Rilindja” me dy paralelet e ndara në Pestovë dhe Vilanc. Lidhur me Zyrën për të Drejtat e Njeriut, tha se është mirë që të hyn në prioritet themelimi i njësive për të drejtat e njeriut, pra me pasë edhe trajtime tjera siç janë: mbrojtja e të drejtave të punëtorëve, qoftë në sektorin privat, qoftë në sektorin publik, pasi që po ndodhin shkelje të të drejtave të punëtorëve, dhe në këtë mënyrë të kemi trajtim më të drejt të personave me aftësi të kufizuara, prandaj është mirë që të fuqizohet kjo zyrë më shumë, sepse kemi të drejtat e pensionistëve, të drejtat e fëmijëve, pasi që jemi vendi i vetëm në Evropë që shkelen të drejtat e fëmijëve, prandaj kjo komunë e ka për detyrë t’i mbrojë këto të drejta, por edhe si asamble e kemi obligimin qytetarë t’i mbrojmë këto të drejta me organe të veçanta në komunë. Në vazhdim i rikujtoi disa premtime që i ka bërë Kryetari i Komunës, e që nuk janë në këtë plan. Ndër to është themelimi i Institutit Kombëtar të Patates. Poashtu Kryetari e ka përmendur që do ta zvogëlon varfërinë, kurse varfëria ka shënuar rritje. Mandej keni përmendur punësimin, ndërsa papunësia ka shënuar rritje. Gjithashtu Kryetari e ka përmendur që do të ketë shkollë në Zhilivodë, në Bukosh, por nuk i kemi ato shkolla.

**Bajram Mulaku-** së pari duhet me pasë parasysh që nuk është raport, por është planifikim, prandaj edhe këtu gjatë debatit duhet ta trajtojmë si planifikim. Pastaj tha se ka mundësi që ndonjë projekt i premtuar, nuk është realizuar, pasi që nuk ka pasë bazë financiare, mirëpo ato që janë mbështetur me vendim të Kuvendit, me mjete financiare, përveç që janë realizuar, të gjitha janë tejkaluar. Me rishikim ka hyrë edhe shkolla e Zhilivodës, dhe gjithashtu në planifikim është edhe për këtë vit, pasi që mjetet që kanë qenë vitin e kaluar, nuk kemi mundur me realizuar mjete aq sa ta përfundojmë edhe këtë shkollë. Mandej shtoi se nuk mund të realizohet çdo gjë që dëshirojmë në komunë, brenda një viti, por janë realizuar edhe shumë punë që vetëm kanë qenë dëshira, pra punë që nuk kanë qenë të planifikuara nga kuvendi, duke përmendur në mënyrë konkrete disa prej tyre. Pastaj lidhur me shkollën e Bukoshit, tha se është në planifikim, dhe janë ndarë mjetet për të filluar, ndërsa lidhur me shkollën e Karaçës tha se duhet menduar se a është e qëlluar të ndërtohet shkolla aty, pasi që numri i nxënësve është i vogël, dhe në raste të tilla sukcesi po mungon, duke shtuar se sukcesi është shumë më i mirë në qendrat shkollore, ku koncentrimi i nxënësve është më i madh, pasi që edhe kontrollimi i punës së mësimdhënësve është më në nivel. Poashtu tha se ju ka thënë qytetarëve të Karaçës se është në interesin e tyre që Komuna t’ua siguron një minibus me i transportuar nxënësit e shkollës fillore për të mësuar në shkollën fillore “Andon Zako Çajupi”, dhe të kenë mësim cilësor, por ata janë kundër këtij propozimi. Në vazhdim sa i përket rrugës “Gjergj Kastrioti- Skënderbeu”, tha se janë planifikuar 100.000 € për të punuar në këtë hapësirë, por kjo shumë në raport me shumën për realizimin e projektit që është bërë, është e vogël, dhe shtoi se është bërë projekti për rrugën “Gjergj Kastrioti- Skënderbeu”, dhe sipas atij projekti, me krejt infrastrukturën do të kushtojë mbi 3 milionë e 500 mijë €, pra duhen mjete relativisht të mëdha për realizimin e atij projekti, por premtoi se me shumën prej 100.000 € do të fillojnë punimet.

**Sabit Kadriu-** tha se brenda një plani nuk mund të parashihen të gjitha detajet. Prandaj ky është një plan i paraqitur në mënyrë të përgjithësuar, kurse në detaje janë drejtorët e drejtorive që do t’i paraqesin. Pastaj tha se edhe vitin e kaluar anëtarët e Kuvendit e kanë kërkuat formimin e Drejtorisë për Bujqësi, pasi që

Kryetari i Komunës me të drejtë e ka vendosur në prioritet bujqësinë, por si do të ketë një bujqësi intensive, përderisa nuk është drejtorja, sepse në mungesë të drejtorisë, vetëm nëpër sektor nuk do të mund të kemi një bujqësi intensive, kurse dihet që Vushtrria është një vend agrar dhe ka nevojë për organizimin e Drejtorisë për Bujqësi, pasi që drejtorja do t'i kishte edhe sektorët tjerë. Pastaj lidhur me shërbimet publike, tha se vitin e kaluar por edhe vitet e mëparshme ka qenë e nevojshme që të ndajmë mjete më tepër për çështjen e rrugëve, kurse tani ka ardhur koha të mendohet për prioritetet tjera, ndër to janë kanalizimet, pasi që numri i popullatës është rritur, dhe nëpër disa fshatra që janë të relëfit të rrafshët kemi probleme me kanalizime, prandaj është mirë që në prioritet të jetë futja e kanalizimeve nëpër bashkësi vendore dhe nëpër të gjitha fshatrat. Mandej lidhur me urbanizimin, tha se më herët ka qenë një plan urbanistik i qytetit të Vushtrrisë, një plan që ka qenë i vjetruar, por sot është mirë ta kemi një plan të detajizuar për shpërndarjen e qytetit të Vushtrrisë, për ndërtime dhe rindërtime, duke u konsultuar me ekspertët më të mirë. Në vazhdim lidhur me arsimin, tha se në fshatin Zhilivodë, Karaçë dhe Bukosh, për shkak të numrit të vogël të nxënësve, është më mirë që këta nxënës t'i bartim nëpër shkollat që janë në afërsi, se sa të organizojmë mësim, të ndërtojmë shkolla, dhe të mos e kemi numrin e nxënësve që është i preferuar sipas rregulloreve dhe Ligjit të Arsimit, dhe aty nuk do të ketë cilësi. Kurse në Bukosh më mirë është të ndërtohet shkolla në pjesën ku është e urbanizuar, se sa në pjesën ku ka qenë atje lart. Pastaj sa i përket kulturës, kërkoi nga Kryetari i Komunës që ta fut në prioritet ndërtimin e një biblioteke moderne, pasi që kemi shumë nxënës, dhe shtoi se renovimi i shtëpisë së Mahmut Agë Gjinollit nuk i plotëson kushtet për të qenë bibliotekë, as muze dhe arkivë. Në fund lidhur me organizimet dhe takimet, tha se Drejtorja për Kulturë këtë vit ka dështuar në organizimin e takimit "Ditët e Hasan Prishtinës", pasi që poetët eminentë kanë ardhur në Vushtrri, po nuk i ka pritur askush. Poashtu kërkoi që të renovohet ose të ndërtohet një Shtëpi e Kulturës.

**Bajram Mulaku-** tha se për ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës janë disa ide, por edhe njoftoi se është investuar edhe gjatë këtij viti në renovimin e saj. Pastaj tha se edhe vet ka dhënë vërejtje se organizimi i ditëve të Hasan Prishtinës, për çdo vit bëhet barrë e rëndë për komunën, prandaj duhet të reduktohet ose çdo 5 vjet, ose çdo 10 vjet. Mandej tha se është një propozim që afër hallës sportive që të ndërtohet diçka edhe për rini, por edhe një bibliotekë e qytetit. Ndërsa sa i përket plani urbanistik, tha se e kemi hartuar planin zhvillimor dhe e kemi aprovuar, kurse në planin zhvillimor janë paraparë 17 pjesë, e që duhet të detajizohen pjesë-pjesë. Ndërsa lidhur me çështjen e Drejtorisë për Bujqësi, tha se Kuvendi ka formuar një komision për ndryshuar dhe plotësuar Statutin e Komunës, dhe le të propozon komisioni në fjalë. Në fund sa i përket kanalizimeve, tha se 25.000 € janë planifikuar për vitin e ardhshëm për furnizim me gypa, 25.000 € janë planifikuar për ndërtimin e kanalizimeve. Poashtu njoftoi se ka nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi me një agjencion zviceran për ndërtimin edhe të rrjetit të ujësjellësit edhe të kanalizimeve, duke participuar Qeveria e Zvicrës, ka gjasa edhe Qeveria e Sllovenisë, gjithashtu edhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Komuna e Vushtrrisë.

**Sami Istrefi-** tha se e gjithë puna e Kryetarit të Komunës dhe e të gjitha drejtorive ka qenë shumë transparente gjatë tërë vitit 2010. Poashtu tha se asnjë e hyrë dhe asnjë shpenzim nuk ka kaluar, pa ardhur për çdo muaj në Kuvend nga Drejtorja për Buxhet. Mandej tha se është shumë pozitive dhe me rëndësi që qytetarët të marrin pjesë në hartimin e planeve rregulluese. Gjithashtu është pozitive planifikimi urban dhe inspeksioni (pikat 43 deri në 46 të paraqitura në tabelë). Në fund në emër të grupit parlamentar të PDK-së e falënderoi Kryetarin e Komunës për punën që ka bërë deri më tani, duke tejkuluar parashikimet me të gjithë drejtorët e drejtorive.

**Pajazit Pllana-** paraqiti vërejtje tek sektori i bujqësisë, lidhur me paragrafin nr. 5, që ka të bëjë me përcjelljen e tregut rreth furnizimeve me inpute bujqësore (plehra, fara etj), duke pyetur se kush i mbikëqyrë dhe kush i përcjellë, agjencioni apo



inspektorati? Pastaj tek sektori i pylltarisë, tha se tani është kompetencë e komunës që pylltarinë ta menaxhoj, kurse në plan thuhet: “Pastrimi dhe rrallimi i pishave në territorin e komunës ku ato gjenden”, por Vushtrria nuk ka vetëm pisha, mirëpo ka edhe male të cilat duhet të hyjnë nën menaxhim dhe mbikëqyrje, por një kujdes i veçantë t’i kushtohet këtij segmenti që të krijohet hapësirë për ambient të shëndoshë. Mandej e përshëndeti angazhimin për gjetje të donatorëve të rindërtimit të kolektorëve dhe implantantëve, por çfarë forme, projekti dhe realizimi është çështje që duhet shikuar. Pastaj tha se formulimi: “në kuadër të bashkësive lokale, shqyrtimi i mundësive për hapje të zyrave lokale në qendrat kryesore lokale të komunës”, nuk është në rregull, dhe propozoi të jetë: “shqyrtimi i mundësive për hapje të zyrave të vendit në bashkësitë lokale, ku ato kanë ekzistuar përpara”. Sa i përket shëndetësisë, tha se nuk figuron askund se ndërtimi i objektit të ambulants shëndetësore në Samadrexhë ka mbetur në kontejner, dhe nuk është i paraparë në vitin 2011. Ndërsa tek mirëqenia sociale, tha se në vend të termit “orientim” duhet thënë “mbështetje”. Në fund tha se në krejt materialin ka një vërejtje, pasi që ka përsëritje, dhe fjalitë nuk janë radhitur siç duhet.

**Bahrije Pllana-** tha se rishikimin e kemi aprovuar në shtator, por e kemi aprovuar me vërejtje, mirëpo vërejtjet nuk janë marrë parasysh, duke përmendur konkretisht tek investimet kapitale (asfaltimi i rrugës në Shtitaricë dhe Dolak), dhe kujtoi se ka bërë pyetje për cilën rrugë është fjala, dhe shtoi se ajo rrugë që të dërgon tek varrezat në fshatin Shtitaricë, ajo rrugë kushton 90.000 €. Poashtu ka kërkuar që kjo rrugë të asfaltohet pa participim të qytetarëve të fshatit Shtitaricë, duke u bazuar në atë se çka është punuar në këtë fshat, është punuar me participim të qytetarëve. Në vazhdim kërkoi përgjigje nga Kryetari i Komunës për cilën rrugë është fjala, pse 80.000 €, dhe pse është përzier këtu edhe Dolaku?

**Qazim Azemi-** replikoi me Kryetarin lidhur me atë që tha të barten nxënësit prej Karaçës në shkollën fillore “Andon Zako Çajupi”, duke shtuar se shkolla e Karaçës dhe shkolla e Zhilivodës kanë nxënës përafërsisht të njëjtë, dhe me i transportuar është vështirë, prandaj kërkoi nga Kryetari që ta parasheh edhe ndërtimin e shkollës fillore në Karaçë.

**Besim Jashari-** i sugjeroi Kryetarit të Komunës që drejtorët e drejtorive të kenë një formë të unifikuar të planit, duke përmendur si shembull pozitiv planin e Drejtorisë për Shërbime Publike, që përmban elementet e nevojshme, për dallim nga plani i Drejtorisë për Arsim që është bërë vetëm sa për adet.

**Bajram Mulaku-** sa i përket formës së planeve nga drejtoritë komunale, lidhur me vërejtjen e B.Jasharit, tha se është vështirë të paraqiten të gjitha drejtoritë me të njëjtën formë të unifikuar të planit, pasi që disa drejtori kanë specifikat e tyre, që dallojnë nga drejtoritë tjera.

**Qerim Selimi-** lidhur me vërejtjet në planin e punës së Kryetarit, sa i përket arsimit, tha se Drejtoria e Arsimit e ka paraqitur planin në pika të shkurta, kurse sa i përket investimeve kapitale janë planifikuar me buxhet që të ndërtohet shkolla në Zhilivodë, dhe në kuadër të kësaj shkolle do të parashihet edhe një klasë shtesë që do të shfrytëzohet edhe si ambulancë për banorët e Zhilivodës. Poashtu njoftoi se ka pasur kërkesë nga banorët e fshatit Karaçë që të ndërtohet një shkollë, por numri i nxënësve të Zhilivodës nuk krahasohet me numrin e nxënësve të Karaçës, dhe mësimi është duke u bërë në mënyrë të kombinuar, për shkak të numrit të vogël të nxënësve. Mandej lidhur me vërejtjen që nuk janë cekur se cilat shkolla do të renovohen, tha se kemi disa premtime gojore nga disa kompani, por këto donacione kërkojnë një bashkëfinancim.

**Besim Jashari-** tha se atë që e mbrojti Kryetari është e pambrojtur, duke përmendur si shembull fillimi i procedurës për furnizim të shkollave me lëndë djegëse, pra Drejtoria e Arsimit duhet me pasë të qartë kur e paraqet kërkesën për furnizim me lëndë djegëse, sepse pastaj faji i mbetet Drejtorisë për Prokurim, pasi që nuk e ka paraparë afatin e furnizimit Drejtoria e Arsimit.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 18 vota “për” , 4 “kundër” të tjerët “abstenim” lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:  
*Aprovohet plani të punës të Kryetarit të Komunës për v. 2011, me vërejtjet dhe sugjerimet e anëtarëve të Kuvendit.***

#### **4. Shqyrtimi i informatës lidhur me realizimin e të hyrave vetanake buxhetore për muajin nëntor 2010.**

**Besim Jashari-** lidhur me formën ballore, tha se kur të bëhet një shkresë duhet të dihet nga kush, kujt po i dedikohet, kurse këtu herë përdoret hartuesi, herë propozuesi. Pastaj tha se në Informatë nuk shkruan as nga kush, as përmes kujt, por as nuk është e nënshkruar nga Kryetari i Komunës, e që do të duhej të ishte e nënshkruar. Pastaj tha se edhe në informatat e kaluara, përgatitësi i referohet periudhës mujore të vitit paraprak, prandaj do të ishte mirë që në Informatë të ceket planifikimi për vitin 2010 dhe realizimi, dhe për vitin 2009 planifikimi dhe realizimi, pastaj të bëhet krahasimi për të kuptuar a ka pasur përmirësim të inkasimit të të hyrave. Mandej paraqiti vërejtje që shifrat në tabelë në disa vende ndahen me pikë, e në disa vende tjera me presje. Në fund tha se të planifikuarit është një aktivitet shumë i rëndësishëm, pasi që kërkon ekspertizë.

**Muharrem Shabani-** tha se pasi që jemi në fund të vitit dhe me qëllim të nxjerrjes së obligimeve dhe realizimit të planeve që po i parashtrijmë tash, është mirë që ta kemi të qartë situatën e obligimeve të mbetura, të pa inkasuara nga institucionet e komunës në komunën tonë, kjo për faktin që kemi një ndryshim, një rritje të të hyrave vetanake që nga rebalanci i vitit të kaluar, dhe rënia në 62 %, e arsyeton këtë kërkesë. Pastaj tha se është edhe obligim që kur do të ndahen objektet kapitale, ndarja e tyre dhe prioritetet të caktohen sipas pagesës së qytetarëve. Mandej tha se është kërkuar disa herë në këtë Kuvend, por të jetë e fundit që po kërkojmë që në raportin vijues të kemi të paraqitura të hyrat e inkasuara sipas vendbanimeve.

**Sabit Kadriu-** tha se në Informatë nuk është dashur fare të përfshihet viti 2009, pasi që vetëm e komplikon, por është dashur të planifikohet për vitin 2011, duke u shikuar raportin e fundit të vitit 2010. Mandej tha se është shqetësuese që vetëm 62 % është realizimi, duke shtuar se është shumë pak inkasimi i mjeteve nga të hyrat vetanake. Mirëpo nëse ne nuk i paraqesim të gjitha bizneset, veprimtaritë të cilat nuk i kryejnë obligimet ndaj komunës, atëherë nuk kemi të drejtë të kërkojmë nga qytetarët, kur vet nuk jemi në nivel.

**Isuf Jashari-** tha se jemi e vetmja komunë që informojmë çdo muaj lidhur me të hyrat vetanake, kurse sa i përket çështjes së raportimit, asnjë komunë nuk raporton në formën e njëjtë, pra nuk ka një formë standarde. Pastaj tha se kanë paraparë që të mbulohen të gjitha investimet kapitale, dhe kur ta shikoni raportin në fund të vitit, 99% është realizuar buxheti, pra të gjitha investimet që janë paraparë, janë mbuluar, me përjashtim në 3-mujorin e fundit (me donacion që janë marrur nga Ministria) është mbetë që të mbulohen në vitin e ardhshëm.

**Bajram Mulaku-** rikujtoi se kjo është një Informatë për inkasimin e të hyrave për një muaj. Pastaj u pajtua me sugjerimin që duhet të bëhet analizë e detajuar për të hyrat e pa alokuara, por është e vështirë të ndahet në Informatë secili regjion se sa ka inkasuar. Mandej tha se me rishikim, në planifikim ka bërë presion tek Drejtoria e Buxhetit që të rritet planifikimi, por ka qenë i vetëdijshëm që nuk mund të realizohet në tërësi ajo rritje e planifikimit, dhe shtoi se edhe pse nuk është i kënaqur me inkasimin e të hyrave, por ato janë më të mira se në vitin e kaluar.

## **5. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për dhënien e lejes së punës të bizneseve në territorin e Komunës së Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).**

**Ismet Gashi-** në emër të grupit parlamentar paraqiti këto vërejtje për draftrregulloren në fjalë: së pari drejtori është dashtë që ta paraqes në arsyetim që rreth draftrregullores në fjalë nuk ka pasë vërejtje dhe sugjerime. Në vazhdim paraqiti vërejtjet tjera, duke shtuar se nuk janë marrë parasysh vërejtjet që ka paraqitur më parë, te neni 3.2, tha se duhet që hiqet termi “shëndetësore” dhe të zëvendësohet me “higjienike”. Te neni 7, nën “b”, pjesa e fundit e kësaj fjalisë “...ose kontratën mbi shfrytëzimin e lokalit me qira, si dhe fletën poseduese të lokalit”, tha se kjo duhet të jetë një pikë e veçantë, për shkak se leja e ndërtimit apo legalizimi duhet të jetë gjithsesi, por duhet ta ketë kontratën mbi shfrytëzimin me qira, me pronarin e objektit. Te neni 9.1, propozoi që të hiqet fjalia “leja e përkohshme” aty ku s’ka leje ndërtimore fare. Neni 12.4, kërkoi të korrigjohet pjesa e fundit e fjalisë “nga dita kur është pranuar ankesa” , dhe të thuhet “nga dita kur është pranuar vendimi prej inspektorit”.

**Bajram Mulaku-** propozoi që nenit 10 t’i shtohet edhe alineja 10.4 me këtë përmbajtje: “Leja për ushtrimin e veprimtarisë afariste mund t’i merret, nëse ushtruesi i veprimtarisë nuk i kryen obligimet komunale të taksës vjetore, e cila duhet të paguhet nga shoqëritë e regjistruara tregtare”.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

- a. Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet për dhënien e lejes së punës për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit në territorin e Komunës së Vushtrrisë;**
- b. Sipas kësaj Rregulloreje asnjë organizatë e biznesit nuk lejohet të ushtrojë veprimtarinë afariste në kundërshtim me ligjin, pa leje pune të lëshuar nga organi përkatës.**

## **6. Shqyrtimi i sërishëm i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të tokës në pronësi të Komunës sipas kërkesës së MPB të Republikës së Kosovës.**

**Përfaqësuesi i ICITAP-it-** paraqiti sqarimet hyrëse.

**Muharrem Shabani-** falënderoi përfaqësuesi i ICITAP-it si donator që ka shprehur gatishmërinë për ta ndihmuar akademinë, mirëpo ndoshta institucionet qendrore të vendit, por edhe ato ndërkombëtare po i hyjnë në hak kësaj komune, që me një buxhet të vogël, dhe me sipërfaqe të vogël të tokave për interesin publik, po mbetet fare pa to. Pastaj tha se edhe më herët kanë kërkuar që për disa objekte të interesit publik të kësaj komune (që çdo herë është në rritje), nuk ka gjetë asnjëherë mirëkuptim deri më tani nga institucionet qendrore, bile edhe me kërkesën e ndërrimit, dhe njoftoi se e tërë sipërfaqja ku gjendet akademia është pronë e Komunës së Vushtrrisë. Pastaj pyeti se me dhënien e kësaj prone, a kemi mundësi që të bëjmë zëvendësimin e sipërfaqes, pasi që ajo është në qendër të qytetit, që kësaj komune do t’i nevojitet në të ardhmen, ose ta zëvendësojmë me hapësira tjera, kurse ajo tokë mos t’i zihet kësaj komune, pasi që është në interes për një ardhmëri më afatgjate, sepse është një ndër vendet më të përshtatshme të lira që e kemi.

**Sami Istrefi-** tha se duhet t’i ipet në shfrytëzim të përkohshëm, sepse ka një rëndësi të veçantë, duke konsideruar që komuna asgjë nuk humb në këtë rast, përkundrazi fiton në aspektin institucional, për shkak se prona që gjendet aty, në rast që do të ishte një pronë e hapur, e lirë, dhe do të duhej të shfrytëzohej për një qëllim të caktuar publik për një periudhë të shkurt kohore, atëherë as parashtruesi i kërkesës nuk do të kërkonte që t’i ipet në shfrytëzim. Pastaj tha se ajo pjesë që ka mbetur ashtu pas lufte, është pjesë e gërmadhave, dhe nuk shfrytëzohet për asgjë, prandaj propozoi që ai lokacion t’iu ipet në shfrytëzim për dy vite, me mundësi vazhdimi.

**Nezir Klinaku-** pyeti përfaqësuesin e ICITAP-it se sa vite iu nevojitet për shfrytëzim ai vend ?

**Përfaqësuesi i ICITAP-it-** tha se kjo pjesë e tokës është deponi e mbeturinave, dhe është një vend i lënë pas dore. Në vazhdim u përgjigj se toka në fjalë iu nevojitet për shfrytëzim në afat kohor prej së paku 5 viteve.

**Bajram Mulaku-** tha se jemi me fat që në Vushtrri funksionon Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim, duke shtuar se për shumë gjëra komuna jonë ka pasur interes që e kemi qendrën në fjalë, edhe në aspektin e punësimit, edhe për çështjen e edukimit të të rinjve etj. Pastaj tha se i tërë objekti i qendrës është mbi tokën që është pronë e komunës. Gjithashtu tha se duhet të shfaqim interesim që të realizohet ky projekt, por njëkohësisht duhet të shfaqim interesim për ta kompensuar tokën, dhe shtoi se ka bërë kërkesë edhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe jemi në bisedime për ta shndërruar këtë tokë, pra është qëllimi të shndërrohet në fakultet. Në vazhdim propozoi që t'ia japim këtë tokë në shfrytëzim, pa të holla, pasi që edhe pjesën tjetër janë duke e shfrytëzuar pa të holla, me kusht që përveç objektit të komunës (pra, i ish-TMK-së), krejt pjesën tjetër ta mirëmbajnë, me e bërë një gjelbërim aty, duke ua dhënë në shfrytëzim të përkohshëm, në afat prej 5 vjetëve me mundësi vazhdimi, dhe me kusht që edhe atë pjesë, por edhe për pjesën tjetër të bëhet ndërrim me një pronë tjetër, duke paraqitur si propozim konkret ndërrimin e tokës me parcelën në të cilën gjendet moteli.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

**a. Për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim të tokës ndërtimore pronë e Komunës;**

**b. Ministrisë së Punëve të Brendshme QKSPEZH në Vushtrri, i lejohet për shfrytëzim toka ndërtimore, në sipërfaqe prej 0.30.00 ha (3.000m<sup>2</sup>), e cila është pjesë e parcelës kadastrale P-70202016-02358-1 dhe parcelës P-70202016-02358-5, të evidentuara në fletën poseduese UL-70202016-03596, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë.**

**c. Patundshmëria e cekur si në nenin 1 të këtij vendimi i ipet në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim për vendosjen e Qytezës Simulative në QKSPEZH në Vushtrri, në afat prej 5 (pesë) vitesh, me mundësi vazhdimi të këtij afati.**

**7. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për fillimin dhe mbarimit të orarit të punës të bizneseve në lëmin e tregtisë, hotelerisë, zejtarisë dhe shërbimeve tjera në territorin e Komunës së Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).**

**Ismet Gashi-** tha se në diskutim publik është kërkuar nga një biznesmen që t'iu lejohet të punohet ndërmarrjeve prodhuese edhe ditëve të diel. Prandaj propozoi që të përfshihet në draftrregulloren në fjalë.

**Besim Jashari-** tha se edhe te drafti për dhënien e lejes së punës, por edhe tek kjo draftrregullore shihet se është i njëjti procesverbal, duke paraqitur vërejtje se diskutimi publik është mbajtur sa për sy e faqe, prandaj sa më shumë që të kyçen bizneset në çështjet që kanë të bëjnë me ta, aq ma shumë do të jenë ata kontribuues në zbatimin e saj. Pastaj tha se është shqetësuese çështja e zbatimit të këtyre rregulloreve, prandaj nëse nuk ka një bashkëpunim të mirë në mes të autoriteteve komunale dhe bizneseve, do të jetë problem zbatimi i këtyre rregulloreve që po i aprovojmë.

**Sami Istrefi-** lidhur me nenin 15.1, propozoi që të pyetet Drejtoria për Shëndetësi se a ka mjete financiare që brenda institucionit publik (QKMF-së) të funksionoj shërbimi i ultrazërit dhe shërbimi i stomatologjisë, pasi që këto shërbime i kërkojnë qytetarët kohë pas kohe, dhe shtoi se në spital pas orës 12 apo 13 nuk punon më ultrazëri, kurse na po kërkojmë që institucionet private të punojnë prej orës 07:00 – 24:00.

**Safet Idrizi-** u përgjigj se QKMF-ja merret me mbrojtje parësore shëndetësore, dhe shtoi se nuk kemi profesionit të ultrazërit, por ultrazëri funksionon në kuadër të spitalit. Sa i përket shërbimit stomatologjik, tha se kemi numër të vogël të stomatologëve.

**Islam Krasniqi-** lidhur me nenin 6.2 propozoi që orari i punës gjatë verës të fillon prej orës 08:00. Te neni 7.3 propozoi t'i shtohet që të dielave të mos punohet në ndërtimtari, pasi që qytetarët kanë qejf të pushojnë, dhe të mos ketë zhurmë, pra neni 7.3 t'i shtohet pika nën "c" me këtë përmbajtje: "Të dielave të mos punohet".

**Nasuf Aliu-** njoftoi se për diskutimin publik janë përpiluar dhe dërguar mbi 160 ftesa për bizneset, por fatkeqësisht vetëm 7 biznese nga të gjitha ato i janë përgjigjur ftesës dhe me ta kemi zhvilluar diskutimin.

**Ferit Idrizi-** lidhur me propozimin që u dha që neni 7.3 t'i shtohet edhe pika nën "c", tha se mos po punojmë diçka që bie ndesh me atë që kanë nevojë qytetarët, prandaj për këtë propozim nuk pajtohet.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

**a. Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës së bizneseve në lëmin e tregtisë, hotelerisë, zejtarisë dhe shërbimeve tjera në territorin e Komunës së Vushtrrisë.**

**b. Organizatat biznesore në pajtim me nenin 1 të kësaj Rregulloreje janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës, të përcaktuar me këtë Rregullore.**

**8. Shqyrtimi propozim-vendimit për dhënien me qira të lokalit pronë e komunës, (lokali para objektit për banim social – lokacioni ish Vushteksi).**

**Bajram Mulaku-** paraqiti sqarimet hyrëse.

**Ismet Gashi-** në emër të grupit parlamentar të LDK-së tha se në parim pajtohen me propozimvendimin në fjalë, por kërkojnë që ky propozimvendim para se të bëhet i plotfuqishëm, të harmonizohet me Ligjin për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, që ka hyrë në fuqi më 15.12.2010.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

**a. Me këtë vendim ipet në shfrytëzim të përkohshëm Shoqatës "Martirët e Lirisë" në Vushtrri, lokali në pronësi të Komunës së Vushtrrisë, i cili gjendet afër objektit të banimit Social rruga : "Jeton Tërstena" Vushtrri. Lokali nr.8 me sipërfaqe S= 62 m<sup>2</sup>.**

**b. Lokali i cekur si në nenin 1 të këtij vendimi epet në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim për zhvillimin e veprimtarisë së zejes së rrobaqepësisë , në kohëzgjatje prej 1 (një) viti me mundësi vazhdimi të këtij afati.**

**Mbledhja përfundoi në orën 15:00.**

**Procesmbajtësi:  
Albanez Tahiraj**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Ferit Idrizi**